

D E K R E T
Nr.3116, datë 9.10.2001

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME NË ZONËN ZGJEDHORE
NR.98, DELVINË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” të Kushtetutës, si dhe të neneve 4 dhe 11 pika 3 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, bazuar në njoftimin e Kryetarit të Kuvendit,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për deputet në zonën zgjedhore nr.98, Delvinë të zhvillohen ditën e diel, datë 18 nëntor 2001, ndërsa raundi i dytë të zhvillohet ditën e diel, datë 2 dhjetor 2001.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani